



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 20 Korrik 2022

Nr: 21

VENDIM

PËR

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 03, DATË 15.07.2022 TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR VENDOSJE SANKSIONI
ADMINISTRATIV**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.07.2022, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetare bashkie dhe njëkohësisht kryetare e bashkisë Lushnjë, për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022

BAZË LIGJORE: Shkonja “d”, pika 1, nenit 21 i “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe shkronja “b”, neni 34 dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ, ka paraqitur pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën nr. 03, datë 15.07.2022, për vendosje sanksioni administrativ ndaj kandidates për kryetare bashkie dhe njëkohësisht kryetare bashkisë Lushnjë për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022 zj. Eriselda Sefa, referuar vendimit nr. 180, datë 30.06.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (*si vijon KSHZ*).

Në seancën e vlerësimit paraprak të datës 20.07.2022, ora 12:00, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa nr. 03, datë 15.07.2022 e KSHZ i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ.

Pas vlerësimit paraprakisht të kriterëve të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, rezulton se KSHZ legjitimohet në kërkimin e tij. KAS ka kompetencën lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e kërkesës në fjalë e cila është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Në këtë kontekst, në mbështetje të nenit 40 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, propozohet kalimi për shqyrtim i kërkesës së KSHZ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “d” dhe nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 03, datë 15.07.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetare bashkie dhe njëkohësisht kryetare e bashkisë Lushnjë, për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022.
2. Seanca për shqyrtimin e kërkesës do të zhvillohet në datën 27.07.2022, në orën 11:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Elvis **ÇEFA** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Relator**